



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC



P.nr.3104/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2307-4/17, e dt. 05.12.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt. 13.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP/II.nr.2307-4/17, e dt. 05.12.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED] nga Fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me dt. 16.10.2017 rreth orës 16:00 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për buqësi dhe pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik pyjor në fsh.Neredime-Jezercë në vendin e quajtur "Te Bashkimi i Lumenjëve", me qëllim vjedhje ka prerë 30 drunjë të llojit ahut me diametër 15-20cm në gjatësi Boniteti -III gjithsejtë në karburantë prej 3.90m³, vlera e dëmit të shkaktuar është 526,50Euro, të cilët drunjë i ka bartur më kamionët më targë të regjistrimit [REDACTED].

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcakton dënim në lartësi prej **200€ (dyqind/euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej 30 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 30 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzet/euro) të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Detyrohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, t'i paguaj shumën në vlerë prej **526.50 €./pesëqind euro e njëzete e gjashtë euro e pesëdhjetë cent/ €**, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **20€ (njëzet/euro)**, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i pandehuri që për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohet ta paguaj shumën prej **30€(tridhjetë/euro)**, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP/II.nr.2307-4/17, e dt. 05.12.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], KK Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoji si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Detyrohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, t'i paguaj shumën në vlerë prej **526.50 €**./pesëqind euro e njëzete e gjashtë euro e pesëdhjetë cent/ €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.3104/17 e dt. 13.03.2018

Sekretarja juridike

Ganimete Avdiu

Gjyqtari i vetëm gjykues

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.